



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

KRYETARI

Nr. 1226 prot.

Ballsh, më 21.03 .2024

PROJEKT – VENDIM

Nr. 16, datë 21 / 03 / 2024

**“MBI MIRATIMIN E MARRJES ME QIRA TË PASURISË NR. 92/9, ZK 1566 , TOKË
ARË PËR NEVOJA TË BASHKISË MALLAKASTËR”**

Në zbatim të nenit 9, pika 1/1, gërma a, pika 1.6, gërma a, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, shkresës me nr. 48 Prot., datë 19.03.2024 “Kërkesë” të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, administruar pranë bashkisë Mallakastër me nr. 1192 Prot., datë 19.03.2024, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me nr. 95, datë 19.03.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e hapësirës (pasurisë) për parkimin e mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Mallakastër”, shkresës me nr. 1192/2 Prot., datë 21.03.2024 “Relacion” të grupit të punës,

PROPOZOJ:

1. Marrjen me qira të pasurisë 92/9, ZK. 1566, me sipërfaqe 2250 m2, në pronësi të Z. Mehmet Likaj referuar dokumentacionit të pronësisë së paraqitur nga ana e qytetarit, për nevoja të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për parkimin e mjeteve që ka në dispozicion (automjete, fadroma, skrepa) etj.
2. Vlera e marrjes me qira e propozuar është 22 000 (njëzetë e dymijë) në muaj.
3. Afati i marrjes me qira do të jetë 3 (tre) vjet me të drejtë rinovimi.
4. Ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për ndjekje dhe zbatim.
5. Ky projekt-vendim shoqërohet me dokumentacionin bashkëlidhur.

Konceptoi: Juristi M. Shehaj
Pranoi: Përgj, N. Sakaj
Miratoi: Drejtor L. Saliaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA MALLAKASTËR
KABINETI KRYETARIT
PROTOKOLLI

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues N. Sh. P. Nr. prot. 48 Data 19.03.2024

Shkurtimi i lëndës: Kërkese

Për trajtim nga:	
Struktura të tjera të ngarkuara	<u>Drejt. B. N. Jurdike</u>
Me porosi	<u>Z. Kryetari</u>

Afati:

Normal (7 ditë)	Prioritet (3 ditë)	Urgjent (brenda ditës)	Pa afat / për dijeni	Tjetër ___ ditë
-----------------	--------------------	------------------------	----------------------	-----------------

19.03.2024
Data _____, Nr. prot. 1192

Nënshkrimi (TITULLARIT) [Signature]

Marrë në dorëzim _____ .2024. Drejtori: Nënshkrimi _____
Kalon për trajtim (struktura): _____ .2024.
Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim _____ .2024. Përgjegjësi: Nënshkrimi _____
Kalon për trajtim (struktura): _____ .2024.
Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim _____ .2024. Specialisti: Nënshkrimi _____
Kalon për trajtim (specialistit): _____ .2024.
Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____ .2024, Sp. _____
Trajtimi i materialit pranuar më: _____ .2024, Përgj. _____
Trajtimi i materialit miratuar më: _____ .2024, Drejt. _____
Trajtimi i materialit konfirmuar më: _____ .2024, Dr.Kabineti _____



1192
19/03/2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
NDËRRMARJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr 48 Prot

Ballsh, me 19.03.2024

L e n d a : Kerkese

BASHKISE


Z QERIM ISMAILAJ MALLAKASTER

Me qenese kontrata e Qerases per, parkimin e mjeteve motorike te NSHP perfundonr me daten 06.05.2024, kerkojme qe nga ana e juaj zhvillimin e procedurave spas ligjit per Prokurimin Publike, per lidhjen e nje kontrate te re.

Ne mirekuptim me ju

DREJTORI

BILBIL VELIAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. 1192 Prot.

Ballsh më, 19.03 .2024

URDHËR
Nr. 95, Datë 19.03.2024

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR PËRCAKTIMIN E HAPËSIRËS
(PASURISË) PËR PARKIMIN E MJETEVE TË NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE
PUBLIKE, BASHKIA MALLAKASTËR**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, si dhe shkresës me nr. 48 Prot., datë 19.03.2024 "Kërkesë" të Ndërmarrjes së Shërbimëve Publiko, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 1192.prot., datë 19.03.2024.

URDHËROJ

I. Ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e hapësirës / pasurisë së nevojshme për parkimin e mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimëve Publike, Bashkia Mallakastër, me përbërje si më poshtë:

- Z. Eljon Ymeraj	Specialist Inxhinier / NSHP	Kryetar
- Z. Ferat Beqiraj	Përgjegjës Sektori Transporti NSHP	Anëtar
- Vladimir Hysenaj	Specialist Kadastre / Topograf, Bashkia Mallakastër	Anëtar

II. Grupi i Punës të kryej verifikimet përkatëse në terren dhe të përcaktoj vendodhjen e përshtatshme për parkimin e mjeteve sipas kërkesës me nr. 48 Prot., datë 19.03.2024.

III. Në përfundim të verifikimit të hartohet relacioni përkatës në lidhje me pasurinën e përshtatshme (shoqëruar me hartë treguese).

IV. Ngarkohet grupi i punës në zbatimin e këtij Urdhëri

V. Ndjek zbatimin e këtij Urdhëri ZV / Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Z. Guri Nuhaj

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR
Qerim Ismailaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTER
GRUPI I PUNËS**



Nr. 1192/12 prot.

Ballsh më, 21 . 03 .2024

RELACION

I mbajtur sot më datë 21.03.2024 në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me nr. 95, datë 19.03.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e hapësirës (pasurisë) për parkimin e mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Mallakastër".

Grupi i Punës i Bashkisë Mallakastër i përbërë nga Z. Eljon Ymeraj, Specialist Inxhinier / NSHP, Z. Ferat Beqiraj, Përgjegjës Sektori Transporti NSHP dhe nga Z. Vladimir Hysenaj, Specialist Kadastrë / Topograf, Bashkia Mallakastër, referuar procedurës së ndjekur në lidhje me evidentimin e pasurisë së përshtatshme për parkimin e mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, janë paraqitur në terren dhe kanë evidentuar se:

Për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të përcaktuara më sipër, pasuria e përshtatshme e evidentuar nga ana e grupit të punës është pasuria me nr. 92/9 me sipërfaqe totale prej 2900 m, ZK. 1566, fshati Dukas Njësia Administrative Qendër.

Kjo pasuri në bazë të verifikimeve të kryera, rezulton si më poshtë:

Sipërfaqe prej 2250 m² në pronësi të Z. Mehmet Sefedin Likaj

Sipërfaqe prej 650 m² shtet.

Kjo pasuri ndodhet në afërsi të institucionit të Bashkisë Mallakastër si dhe është një ambient iurvejuar nga kamerat dhe është i ëprshatshëm për objektin e kërkesës së Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Në bazë të kontaktit të marrë me qytetarin, pronar i sipërfaqes prej 2250 m², vlera e kërkuar nga ana e tij për qiranë mujore të kësaj sipërfaqe është 22 000 (njëzetë e dymijë) lekë / muaj.

GRUPI I PUNËS

Eljon Ymeraj

Ferat Beqiraj

Vladimir Hysenaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

PLANVENDOSJE TË PARCELAVE TË TOKES BUJQËSORE

BASHKIA MALLAKASTËR

ZONA KADASTRALE 1566

FSHATI Aulas

NUMRI I PASURISË 92/9

NJËSIA ADM. Qendër

SIPËRFAQA E PASURISË 2250 m²

SHKALLA E HARTËS 1:2500

KUFIZIMET: VERI



Punoi: Specialist Kadastre

Topograf: Vladimir Hysenaj